



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:283809

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810268

KPPP.nr. 2187/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, me seli në Prishtinë, rr. “Bill Klinton”, p.n., kundër debitorit Free Shop Amra, me seli në Fushë Kosovë, rr. “Dardania”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 1523/23 të datës 02.11.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 11.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Free Shop Amra, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 1523/23 i datës 02.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, me datë 02.11.2023 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 1523/23 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Kartela Financiare e Konsumatorit me shifrën ... për periudhën kohore 2022 - 2023, ashtu që është detyruar debitori që në emër të borxhit të papaguar për shërbimet e komunale – bartjen e mbeturinave, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 43.126 EUR, me kamatë prej 4.3 %, nga dita e lejimit të përbarimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor me arsyetim se propozimi për përbarim nuk përmban numrin e biznesit apo të dhëna të tjera për debitorin, ashtu që lehtësisht mund të ngatërrohet me kompani të tjera apo të

ngjashme. Ka shtuar se ekstrakti është në kopje, e jo në original apo kopje të vërtetuar. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, duke sqaruar se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit që përcaktohet si dokument i besueshëm, e që është i përshtatshëm për përmbartim. Ka shtuar se prapësimi i debitorit është kontradiktor për faktin se në dispozitivin e aktvendimit si debitor paraqitet Luxury Auto Sh.P.K, duke u paraqitur dy debitor të ndryshëm. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, si dokumente të besueshme listohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Ndërsa, me nenin 38 të këtij ligji përcaktohet se *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*.

Duke iu referuar dispozitave të lartcekura dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata konstaton se propozimi për përmbartim nuk i plotëson elementet kumulative të përcaktuara me nenin 38 të LPP-së fillimisht sa i përket emërtimit dhe identifikimit të debitorit kjo pasi që si në propozimin për përmbartim, ashtu edhe në ekstraktin nga librat afarist, si debitor

evidentohet “Free Shop Amra,” por që këto të dhëna nuk janë të mjaftueshme për identifikimin e debitorit, konkretisht identifikimin e palës e cila detyrohet nga ky ekstrakt i librave afarist, kjo pasi që meqenëse dokumentit i mungon si numri personal, ashtu edhe numri i biznesit të debitorit.

Në anën tjetër, gjykata gjeti se propozimi për përmbarrim nuk përmban në mënyrë të qartë as kredinë e cila kërkohet të realizohet kjo pasi që në propozim, është specifikuar periudha kohore nga data 31.01.2023 e deri më datë 31.10.2023 në vlerë prej 43.12 EUR, ndërsa në ekstraktin nga librat afarist, rezulton se shuma prej 43.12 EUR, është mbetja e borxhit nga periudha 31.05.2012 e deri më datë 31.10.2023, por e cila periudhë, nuk është përfshirë në propozimin për përmbarrim.

Përkundër kësaj, Përmbarruesi Privat si organ përmbarrues në këtë çështje përmbarrimore, edhe pse ka qenë i obliguar që të kërkoj nga pala kreditore evitimin e të metave të propozimit për përmbarrim, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 38, par.2 të LPP-së me të cilin parashihet se *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”*

Në këtë drejtim, referuar nenit 43, par.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimi për përmbarrim nuk përmban në mënyrë të qartë palën debitore dhe nuk përmban në mënyrë të qartë kredinë që kërkohet të realizohet.

Nga si më sipër, dhe duke u bazuar në nenin 73, par.3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2187/23, datë 11.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.